Abstrakt: Emetimi në mjedis i ndotësve të ndryshëm, të shkaktuar nga aktiviteti i industrisë tekstile, shkaktohet paraprakisht nga substancat që ndodhen në lëndën e parë (papastërti dhe materiale që shoqërojnë fibrat natyrale, agjentë paratrajtues, lubrifikantë të tjerjes, agjentë kollaritës, etj). Të gjithë këto substanca, zakonisht, largohen nga fibrat në procesin e përpunimit përgatitor para ngjyrimit dhe përmbarimit. Largimi i substancave ndihmëse gjatë paratrajtimit në të njomë krijon jo vetëm ndotje organike me shkallë të ulët biodegradimi (vajrat mineralë), por shkakton edhe emetim të substancave me rrezikshmëri të lartë, si hidrokarbure poliaromatikë, alkil fenol etoksilate dhe biocide. Nevoja kimike për oksigjen (NKO) e ujërave të ndotura nga këto procese paratrajtuese është 40 – 80 g/kg fibër. Në rastin kur materialet përpunohen në rrugë të thatë (stabilizim termik) shkaktohet ndotje e konsiderueshme në ajër. Ujërat e larjes, që shkarkohen nga fabrikat e çkollaritjes të materialeve celulozike, përmbajnë afro 70% të ngarkesës së përgjithshme të ndotësve që ndodhen në shkarkimet ujore. Nga ana tjetër përdorimi i agjentëve zbardhës me bazë klori çojnë në formimin e komponimeve klor-organike të absorbueshme, sasia e të cilëve në ujëra është në vlerat 90-100 mgCl/l. Në rastin kur procesi i zbardhimit kryhet me peroksid hidrogjeni, H₂O₂, ndotjet shkaktohen nga përdorimi i agjentëve kompleks-formues (stabilizues). Në rast se nuk aplikohet procesi i rikuperimit të NaOH pas procesit të mermerizimit, në sistemin e trajtimit të shkarkime derdhen ujëra që përmbajnë 40-50 g NaOH/l.

Fjalë kyç: *agjentë paratrajtues, NKO, zbardhues, shkarkime ujore, biodegradim*

TECHNOLOGICAL ALTERNATIVES OF REDUCING ENVIRONMENTAL CONTAMINATION LEVEL DURING THE PRETREATMENT PROCESS OF THE TEXTILE MATERIALS

Prof. Asoc. Spiro DRUSHKU¹, M.Sc. Majlinda HYLLI², M.Sc. Elmira DUMISHLLARI²

¹ University of Tirana
Faculty of Natural Sciences
Department of Chemical Industry
² Polytechnic University of Tirana
Faculty of Mechanical Engineering
Department of Textile and Fashion
sdrushku@yahoo.com

Abstract: A large percentage of the total emission load from textile industry activities is attributable to substances that are already on the raw material (e.g. impurities and associated materials for natural fibres, preparation agents, spinning lubricants, sizing agents, etc.). All these substances are usually removed from the fibre during the pretreatment process before colouring and finishing. The removal of auxiliaries by wet treatment may lead to the discharge not only of hard-to-biodegrade organic substances (mineral oils), but also of hazardous compounds such as polyaromatic hydrocarbons, APEO and biocides. Typical COD loads are in the order of 40 - 80 g/kg fibre. When the substrate is submitted to a dry process (heat-setting), caused the air pollution. The washing water from the desizing of cotton and cotton-blend fabrics may contain 70 % of the total COD load in the final effluent. On the other hand, application of the bleaching by sodium hypochlorite caused the creation of adsorbable organic halogens (AOX). In hydrogen peroxide bleaching the environmental concerns are associated with the use of strong complexing agents (stabilisers). A strong alkaline effluent (40 - 50 g NaOH/l) is produced if the rinsing water after mercerizing is not recovered or re-used.

Keywords: *preparation agents, COD, bleaching agents, water waste, biodegradation*

TEKNIKA E IDENTIFIKIMIT TË FIGURËS SË FEMRËS PËR PRODHIMIN E VESHJEVE

Dr. Ermira SHEHI, Ing. Tatjana SPAHIU

Universiteti Politeknik i Tiranës
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti i Tekstilit dhe Modës
tatjana.spahiu@upt-tekstilmoda.org

Abstrakt: Femrat e çdo moshe mund të ketë një trup tërheqës vetëm nëse ato kanë qëndrim të mirë të trupit, si dhe mbajnë veshje të cilat i përshtaten me trupin. Qëndrimet e duhura trupore lidhen me defektet që shfaqin veshjet gjatë mbajtjes së tyre. Një hap i rëndësishëm në realizimin e një veshjeje është njohja e trupit, mbi të cilin dhe për të cilin do të përgatitet veshja. Aktualisht sistemi i përmasave të veshjeve në vendin tonë bazohen në një studim të kryer rreth 20 vite më parë. Metodatat e përmasimit sot në botë kanë ndryshuar. Që prej përpjekjes së disa viteve më parë për marrjen e sistemit të përmasimit, zhvillimi i trupit të femrave rrjedhimisht edhe përmasat e tyre kanë ndryshuar. Probleme të tilla si përshtatja e veshjeve në trupin e konsumatorit dhe defektet e lidhura me to përbëjnë element jo pozitiv të cilat shfaqet në rritje. Pavarësisht se si një veshje arrin të përshtatet konsumatorit është e nevojshme të fillohet me përmasat elementare për modelimin e një veshjeje. Fakti që sistemi aktual i përmasimit qëndron shumë larg përballë një fakti të tillë atëherë kjo përbën një problem shumë të rëndësishëm për tregtarët e pakicës por edhe vetë prodhuesit. Tashmë janë të përdorshme teknologji të reja dhe të përmirësuara të cilat lejojnë klasifikimin e pamjes reale të përmasave të njeriut në kategori të caktuara të cilat do të pasqyrojnë më mirë përmasat e vërteta që do të bënin edhe dallimin mes vetë popullsisë. Fuqia e shkencës së informatikës e pasqyruar në skanimin e trupit në përmasa 3-dimensionale, programet e dizenjimit të përmasave të trupit si dhe software të tjera ndihmëse po përbëjnë avantazhe të rëndësishme në procesin e prodhimit të produktit gjë e cila do të çojë në përdorimin e një teknologjie të lartë në përfitimin më pas të veshjeve ashtu siç ato janë dizenuar që në fillim.

Fjalë çelës: *trupi i femrave, modelimi i veshjeve, skanimi i trupit për marrjen e përmasave*

TECHNIQUES OF IDENTIFICATION FEMALE BODY FOR GARMENT PRODUCTION

Dr. Ermira SHEHI, Ing. Tatjana SPAHIU

Polytechnic University of Tirana
Mechanical Engineering Faculty
Department of Textile and Fashion
tatjana.spahiu@upt-tekstilmoda.org

Abstract: Females of all ages might have an attractive body only if they have an attractive body posture and if they keep appropriate dresses for their bodies. The proper body postures are related to the defects that the dresses can show. An important step in the realization and modeling of a garment is to know and understand well the body which we are going to produce the garment for. Actually, the measurement system in our country is based on a study many years ago (about 20). So far, the methods of the body measurement worldwide have changed and progressed. Since the first effort to build a measurement and sizing system, the females body shapes and sizes have changed. Such problems as garment fit and the defects related to it are not very good elements and issues in garment production industry. Despite the fact of how a garment can fit to the consumer body it is necessary to start with basic measurements for the garment modeling. The actual sizing system is far from the above mentioned fact and this is a big concern for the retailers and the producers themselves. New and improved technologies developed nowadays allow the classification for the real body shapes into different categories which better reflect the real measurements making also the distinction among different population categories. The development of the informative science with the 3D body measurements, the design programs and other applicative softwares are good advantages in the production process.

Keywords: *body shapes, garment modeling, 3D measurement scanning*

Poster

Poster presentation

IMPACT OF TEXTILE INDUSTRY IN THE ENVIRONMENT; CHALLENGES TOWARD ECO-FRIENDLY TEXTILES

Elda MARKU¹, Majlinda HYLLI²

¹University of Tirana, Albania, Faculty of Natural Sciences
Chemistry Department

²Polytechnic University of Tirana, Albania, Faculty of Mechanical
Engineering,
Department of Textile and Fashion
eldamarku@hotmail.com

Abstract: The textile industry has been condemned as being one of the world's worst offenders in terms of pollution, because it requires a great amount of two components: chemicals: as many as 2,000 different chemicals are used in the textile industry, from dyes to transfer agents; and water: a finite resource that is quickly becoming scarce, and is used at every step of the process both to convey the chemicals used during that step and to wash them out before beginning the next step. The water becomes full of chemical additives and is then expelled as wastewater; which in turn pollutes the environment by the effluent's heat, by its increased pH and because it's saturated with dyes, de-foamers, bleaches, detergents, optical brighteners, equalizers and many other chemicals used during the process. Traditionally produced fabrics contain residuals of chemicals used during their manufacture chemicals that evaporate into the air we breathe or are absorbed through our skin. Some of the chemicals are carcinogenic or may cause harm to children, while others may trigger allergic reactions in some people. Important environmental concerns related to textile wet processing are: chemical intensive wet processing – scouring, bleaching, mercerizing, dyeing, printing etc., heavy metals found in dyestuffs auxiliaries, binders etc., residual dyestuffs, chemicals in water due to poor fixation of colors, PVC and phthalates used in plastisol printing paste, formaldehyde found in dispersing agents, printing paste and colorant fixatives. Eco-textiles are any textile product, which is produced in eco-friendly manner. There are a variety of textiles considered "environmentally-friendly" first for the re-new ability of the product. The second factor is the ecological footprint of the resource - how much land (usually measured in acres) it takes to bring one of the individuals (plants or animals) to full growth and support it. The third thing to consider in determining the eco-friendliness of a particular product is how many chemicals it requires to grow/process it to make it ready for market. Fabrics considered in this list include organic cotton, organic silk, organic wool, soy silk, milk-silk, pine apple fabrics, Hemp, Peat, bamboo, etc.

Keywords: *dye, wet processing, eco-textile, environmental friendly*

NDIKIMI I INDUSTRIËS TEKSTILE NË MJEDIS; SFIDAT DREJT TEKSTILEVE MIQËSORE NDAJ MJEDISIT

Elda MARKU¹, Majlinda HYLLI²

¹Universiteti I Tiranës, Shqipëri, Fakulteti i Shkencave të Natyrës
Departamenti i Kimisë

² Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri, Fakulteti i Inxhinierisë
Mekanike,
Departamenti i Tekstilit dhe Modës
eldamarku@hotmail.com

Abstrakt: Industria e tekstilit ka qenë dënuar si një ndër kundravajtësit më të këqinj në botë për sa i përket ndotjes, sepse ajo kërkon një sasi të madhe të dy komponentëve: kimikate dhe ujë. Rreth 2.000 kimikate të ndryshme përdoren në industrinë e tekstilit, që nga ngjyrat e deri në agjentët transferues. Ndërsa uji, burimet e të cilit po pakësohen gjithnjë e më shumë, nevojitet në çdo hap të procesit industrial, si për të përcjellë kimikatet e përdorura, ashtu edhe për shpëlarjen e tyre. Uji ngopet me shtesa kimike dhe nxirret në formën e shkarkimeve, të cilat nga ana e tyre e ndotin mjedisin me nxehtësinë e tyre, me pH e rritur dhe me kimikatet që përmbajnë: ngjyronjës, shkumëzues, detergjentë, zbardhues optikë dhe shumë kimikate të tjera. Pëlhurat e prodhuara tradicionalisht përmbajnë mbetjet e kimikateve të përdorura gjatë prodhimit të tyre: substanca kimike që avullojnë në ajrin që thithim ose absorbohen nëpërmjet lëkurës sonë. Disa nga kimikatet janë kancerogjene, ose mund të shkaktojnë dëme tek fëmijët, ndërsa të tjerë mund të shkaktojnë reaksione alergjike në disa njerëz. Problemet më të rëndësishme mjedisore të lidhura me përpunimin e njomë të tekstilit janë: përpunimi kimik intensiv në të njomë - pastrimi, zbardhja, ngjyrosja, printimi etj., metalet e rënda që gjenden në bojëra, në lidhës, etj., mbetjet kimike të bojërave në ujë për shkak të fiksimit të dobët të ngjyrave, PVC dhe ftalate të përdorur në pastën e printimit, aldehidi formik që gjendet në agjentët dispergues, në pastën printuese dhe fiksuesit e ngjyrave. Eko-tekstilet janë çdo produkt tekstil që është prodhuar në mënyrë miqësore me mjedisin. Ka një larmi të tekstileve të konsideruar të tillë, së pari për aftësinë e produktit për t'u ripërtëritur. Faktori i dytë është gjurma ekologjike e burimit - sa tokë (zakonisht matet në hektarë) duhet për të rritur e mbajtur një nga individët (bimët ose kafshët). Gjëja e tretë për t'u marrë parasysh në përcaktimin e një eko-produkti të veçantë është se sa kimikate kërkon ai për ta bërë gati për treg. Tekstilet që bëjnë pjesë në këtë grup janë pambuku organik, mëndafshi organik, leshi organik, mëndafshi i sojës, kërpi, torfa, bambuja, etj.

Fjalë kyçe: bojë, përpunimi i njomë, eko-tekstil, miqësor me mjedisin

KRAHASIMI I METODAVE ITALIANE, AMERIKANE DHE ZVICERIANE NË NDËRTIMIN E KALLËPEVE TË VESHJEVE

Dr. Ermira SHEHI¹, Ing. Albana LETI¹

¹Universiteti Politeknik i Tiranës
Departamenti i Tekstilit dhe Modës
ermira.shehi@upt-tekstilmoda.org

Abstrakt: Zhvillimi i pandërprerë ekonomik – shoqëror i vendeve të ndryshme, ka sjellë rritjen e mirëqenies dhe të nivelit kulturor, gjë që ka krijuar kushte për rritjen e kërkesave sasiore dhe cilësore edhe për konfeksionet. Për shkak të evoluimit të modës, veshjeve fantazuese dhe ekstravagante të hedhura në treg, prerjeve elegante të krijuar nga stilistë të ndryshëm, nevojiten prerje bazë më të thjeshtëzuara, që mund të përpunohen më lehtë në repartet e konfeksioneve. Industria e konfeksioneve në vendin tone është një degë relativisht e re. Në fillimet e kësaj industrie u vu re influenca e dy metodave Italiane dhe Franceze në ndërtimin e bazave të thjeshta dhe modelimin e veshjeve. Një sistem i ri prerjesh është “Metoda Zvicerane”. Metoda “Italiane” është një metodë që po përdoret shumë vitet e fundit në Shqipëri. Një tjetër metodë që është aplikuar në Shqipëri është edhe “Metoda Amerikane”. Njohja studimi dhe krahasimi i tre metodave Italiane ,Amerikane dhe Zvicerane të marra në shqyrtim konsiston në ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet:

- 1.Pikave antropometrike,
- 2.Tabelave dhe përmasave.
- 3.Formulave empirike të përdorura.

Prerjet duhet të kenë një funksion specifik që është ai i mbulimit të trupit të njeriut në lidhje me strukturën,anatominë dhe nevojat fizike dhe estetike.

Fjalët kyçe: Veshje, kallëp, prerje,matje antropometrike

THE COMPARISON OF ITALIAN, AMERICAN AND SWISS METHODS FOR CONSTRUCTION OF APPAREL PATTERN

Dr. Ermira SHEHI¹, Eng. Albana LETI¹

¹ Polytechnic University of Tirana
Department of Textile and Fashion
ermira.shehi@upt-tekstilmoda.org

Abstract: The uninterrupted economic and social development of various countries has brought about the increase of welfare and cultural level, which has created suitable conditions for the growth of quantitative and qualitative requirements even for apparels. Due to the evolution of fashion, the fantasy and extravagant clothes in the market, the elegant cuts created by different stylists, more basic simplified apparels are needed, which can be easily processed in the apparels' units. Apparel industry in our country is a relatively new branch. In the beginnings of this new industry, there was noticed the influence of the two Italian and French methods in the setup of simple bases and apparel modeling. A new system of cuts is "The Swiss Method". The "Italian" method is a method widely used in Albania during the recent years. Another method applied in Albanian is also the "American Method". The recognition, study and comparison of the three examined methods, Italian, American and Swiss, consist in the differences and similarities among the following:

1. Anthropometric points,
2. Tables and dimensions
3. Empirical formulas used

Cuttings should have a specific function, which is that of covering the human body in accordance with the structure, anatomy and physical and esthetic needs.

Keywords: *pattern, garment, cutting, anthropometric measurement.*

MODELI TEORIK I SJELLJES NË SHTYPJE TË TRIKOTAZHEVE THURJE BAZË ME SPACIO

Fatemeh MOKHTARI¹, Mahnaz SHAMSHIRSAZ² Masoud LATIFI¹,
Mohammad MAROUFI²

¹ *University of Technology, Tehran, Iran
Textile Engineering Department
Textile Research and Excellence Centers, Amirkabir*

² *University of Technology, Tehran, Iran
New Technology Research Center, Amirkabir
matt@aut.ac.ir*

Abstrakt. Pëlhura me hapësira (spacio) është një pëlhurë tre-dimensionale e trikotazhit e përbërë nga dy substrate të tekstit të jashtëm të cilat bashkohen dhe mbahen në distancë nga fije lidhëse. Trikotazhet me spacio përdoren për arsye mjedisore, dhe kanë aplikime në grupin e produkteve të ndryshme të tilla si tekstili për mjetet e transportit (mbulesa të sediljeve të makinës mbulon, mbulesa të paneleve), tekstile industriale, tekstile mjekësore, tekstile sportive dhe veshje bazë. Trikotazhi thurje bazë është zakonisht teknologjia më e përdorur për prodhimin e pëlhurave me spacio. Pëlhura me spacio shfaq karakteristika të veçanta në krahasim me tekstilet konvencionale për shkak të strukturës së saj të mrekullueshme poroze 3-D. Rezistenca në shtypje është një tipar i veçantë i dobishëm për stabilitetin strukturor të pëlhurave me spacio, dhe kjo është një veti e nevojshme për të plotësuar kërkesat për ngarkesa të përhershme apo të çastit dhe në rikthim. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të zhvillojë një model teorik për të parashikuar sjelljen në shtypje të një pëlhure trikotazhi thurje bazë me spacio dhe krahasimin e tij me të dhënat eksperimentale. Të gjitha mostrat e nevojshme janë prodhuar në makinë Rachel me dy shtretër gjilpërash me trashësi densitet dhe thurje të ndryshme. Teoria themelore është bazuar në modelimin e fijeve të shumëfishuara si shufra të lakuara. Rezultatet e teorike të bazuara në supozimin e fije grumbull se fijet e shumëfishuara janë shufra të lakuara janë më afër me rezultatet eksperimentale të këtyre pëlhurave me spacio krahasuar me modelet e mëparshme teorike të literaturës.

Fjalët kyçe: *pëlhura me spacio, sjellje në shtypje, shufra të lakuara, model teorik*

THEORETICAL MODEL OF COMPRESSIBILITY BEHAVIOUR OF WARP KNITTED SPACER FABRICS

Fatemeh MOKHTARI¹, Mahnaz SHAMSHIRSAZ² Masoud LATIFI¹,
Mohammad MAROUFI²

¹ University of Technology, Tehran, Iran
Textile Engineering Department
Textile Research and Excellence Centers, Amirkabir

² University of Technology, Tehran, Iran
New Technology Research Center, Amirkabir
matt@aut.ac.ir

Abstract: Spacer is a three-dimensional knitted fabric consisting of two outer textile substrates which are joined together and kept apart by spacer yarns. Spacer fabrics are used for environmental reasons, which can be used in different product group such as mobile textile (car seat covers, dashboard cover), industrial textile, medical textile, sport textile and foundation garments. Warp knitting is the most commonly used technology for production of spacer fabrics. Spacer fabrics present special characteristics compared to conventional textiles due to their wonderful porous 3-D structures. The compression resistance is a distinct feature beneficial for the structural stability of spacer fabrics, and it is proper to fulfill permanent or instant loading and recovery requirements. The goal of this research is to develop a theoretical model to predict the compressibility behaviour of warp knitted spacer fabric and compare it with experimental data. All required samples were produced on two needle bars Rachel warp knitting machine with different thickness, stitch densities and texture designs. The basic theory is based on modeling pile yarns as curve bar. The theoretical results related to the assumption of pile yarn as curve bar are closer to the experimental results of these spacer fabrics comparing to the previous theoretical models in literature.

Key words: *Spacer fabrics, Compressibility behaviour, Curved bar, Theoretical model*

MEKANIZMI KATERHALLKASH PLAN DHE SINTEZA E TIJ PËR KATËR RAPORTE SHPEJTËSIE TË KËRKUAR

Miranda KULLOLLI¹, Odise KOÇA¹, Lenonard.ÇOMENI²

¹Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti i Mekanikës

² Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
Departamenti i Strukturave
kullolli_m@yahoo.com

Abstrakt: Shpesh duhet të ndërtohen mekanizma katër hallkash plan, që përdoren dhe në makinat e punimit të tekstileve, për një zonë të caktuar të raportit të shpejtësisë këndore të bilancierit me atë të manivelës. Për këtë gjatë sintezës së mekanizmit ndërtohet një sistem ekuacionesh jo lineare nga koordinimi i çiftit të zhvendosjeve këndore ϑ_{13} ; μ_{13} dhe i dy raporteve shpejtësie ν_1, ν_3 . Ndryshimi i μ_1 jep një pafundësi zgjidhjesh. Nëse për hallkën udhëheqëse jepen tre raporte shpejtësisë ν_1, ν_3, ν_5 dhe dy zhvendosje këndore μ_{13}, μ_{15} mund të gjendet një familje e mekanizmave, për të gjitha paraqitjet e ν_1 të μ_1 dhe të ν_3 të $\mu_1 + \mu_{13}$, gjatë ndryshimit të ϑ_{13} për një fare μ_1 ; prej së cilës përcaktohet mekanizmi për ν_5 (të dhënë) të $\mu_1 + \mu_{15}$. Nëse jepen; katër raporte shpejtësie $\nu_1, \nu_3, \nu_5, \nu_7$; dhe tre kënde $\mu_{13}, \mu_{15}, \mu_{17}$; duke përdorur të njëjtën rrugë krijohet një familje mekanizmash katër hallkash, të gjitha paraqitjet e tyre për ν_1, ν_3, ν_5 , respektivisht $\mu_1, \mu_1 + \mu_{13}, \mu_1 + \mu_{15}$; prej së cilës përcaktohen paraqitja e mekanizmit për ν_7 e kërkuar të $\mu_1 + \mu_{17}$.

Fjalë kyç: sintezë, mekanizëm katër hallkash, makinat e punimit të tekstileve, zhvendosje këndore, shpejtësi këndore, hallka udhëheqëse, raport shpejtësie.

FOUR – BAR LINKAGES AND ITS SYNTHESIS UP TO FOUR PRESCRIBED VELOCITY RATIOS

Miranda KULLOLLI¹, Odise KOÇA¹, Lenonard.ÇOMENI³

¹Polytechnic University of Tirana, Mechanical Engineering Faculty
Mechanical Department

² Polytechnic University of Tirana, Civil Engineering Faculty
Department of Structures
kullolli_m@yahoo.com

Abstract: Often should be designed four bar mechanisms plan, that used to manufacture textile machines, for a given area ratio of angular velocity to that of the input and output link. Equations for synthesizing a four-bar linkage to coordinate one angular displacement pair $\theta_{13}; \mu_{13}$ and matching two velocity ratios $\nu_1; \nu_3$ are reproduced. Varying μ_1 yields a family of infinite solutions. If three velocity ratios $\nu_1; \nu_3; \nu_5$ with two angular displacements $\mu_{13}; \mu_{15}$ of the input are prescribed, a family of linkages, all exhibiting ν_1 at μ_1 and ν_3 at $\mu_1 + \mu_{13}$, can then be found by varying θ_{13} for a certain μ_1 , from which the linkage exhibiting the prescribed ν_5 at $\mu_1 + \mu_{15}$ may be located. If four velocity ratios $\nu_1; \nu_3; \nu_5; \nu_7$ with three angles $\mu_{13}; \mu_{15}; \mu_{17}$ are prescribed, repeating the above mentioned procedure yields a family of linkages, all exhibiting $\nu_1; \nu_3; \nu_5$ at $\mu_1; \mu_1 + \mu_{13}; \mu_1 + \mu_{15}$ may be located.

Keywords; *synthesis, four-bar linkage, manufactures textile machine, angular displacement, angular velocity, input link, velocity ratios.*

PROBLEME SPECIFIKE TË KALIBRIMIT TË APARATEVE MATËS TË LAGËSHTISË NË MJEDISËT TEKSTILE

M.Sc. Ing.Kreshnik HAKRAMA¹, Prof. As. Dr. Genti GUXHO², Prof. As. Dr.
Akli FUNDO³

¹ Ekspert i kalibrimit të aparateve matës

² UPT, Departamenti i Tekstilit dhe Modës

³ UPT, Departamenti i Inxhinierisë Matematike

k_hakrama@yahoo.com

Abstrakt: Procesi teknologjik në industrinë tekstile, sidomos në fazat e para të tij ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga lagështia dhe temperatura e ambientit. Kjo vjen për shkak të higroskopicitetit të materialeve tekstile. Po kështu, matjet tekstile të riprodhueshme kanë si kusht themelor lagështinë $65 \pm 5\%$ dhe temperaturën $20 \pm 2^\circ\text{C}$. Kështu që, kërkohet një monitorim i mirë i kushteve të mjedisit dhe për më tepër me aparate të kalibruar me referenca etalon te gjurmueshëm. Artikulli jep një shembull të kalibrimit të instrumenteve matës të lagështisë relative të mjedisit në industrinë dhe laboratorët testues të tekstilit. Përpyekja e bërë konsiston në ri-vendosjen e një njësie në Shqipëri të aftë për kalibrimin e aparateve të matjes së lagështisë në mjedise të mbyllura. Artikulli pasqyron dhe gjetjet nga krahasime ndër-laboratorike me laboratorë të specializuar në botë.

Fjalë kyç: lagështi e ajrit, kalibrimi i aparateve matës, mjedisi tekstil, laboratorë testues

SPECIFIC PROBLEMS OF CALIBRATION OF MEASURING APPARATUS OF HUMIDITY IN TEXTILE FACILITIES

M.Sc. Eng.Kreshnik HAKRAMA¹, Prof. Assoc. Dr. Genti GUXHO²,
Prof. Assoc. Dr. Akli FUNDO³

¹ Expert in the calibration of the measuring apparatus

² UPT, Department of Textile and Fashion

³ UPT Department of Mathematical Engineering
k_hakrama@yahoo.com

Abstract: Technological process in the textile industry, especially in its early stages is significantly affected by humidity and ambient temperature. This is due to hygroscopicity of textile materials. Likewise, textile reproducible measurements have as a fundamental condition humidity $65 \pm 5\%$ and temperature 20 ± 2 °C. Due to this is required a better monitoring of environmental conditions using calibrated apparatus with traceable reference standard. The paper gives an example of calibration of measuring instruments of relative humidity of the environment in the industry and the measuring laboratories of textile. Attempt made consists of re-establishing a unit in Albania, capable of calibrating the apparatus to measure the indoor relative humidity. The paper reflects the findings from comparisons with specialized laboratories in the world.

Keywords: *relative humidity, calibration of measurement apparatus, textile industrial environment, testing laboratory*

EKO – TEKSTILET. PRODHIMI DHE FUSHAT E PËRDORIMIT TË TYRE

M.Sc. Ing. Silva SPAHIJA¹

¹Universiteti Politeknik i Tiranës
Departamenti i Tekstilit dhe Modës
silva.spahija@upt-tekstilmoda.org

Abstrakt: Industria e tekstileve është konsideruar si industria ekologjike më dëmtuese në botë, për shkak se ajo kërkon një përdorim të madh të dy komponentëve si: kimikatet dhe ujit. Problemet mjedisore në industrinë tekstile ndodhin gjatë shumë proceseve të prodhimit dhe përparojnë drejt produktit përfundimtar. Tre faktorë kryesorë që mund të përmendim ndërsa vlerësojmë pajtueshmërinë e produkteve tekstile me natyrën janë:

- Prodhimi
- Përdorimi
- Hedhja e mbetjeve

Eko-Tekstilet, janë tekstile të krijuara nga fibra të rritura në mënyrë organike, me procese ngjyrimi dhe stampimi “miqësore”-mjedisore. Ato janë produkte tekstile që mund të prodhohen, përdoren dhe prirën të mos prishin balancën ekologjike dhe të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Teknologjia e prodhimit të Eko-tekstileve, tenton që ta bëjë prodhimin e tyre sa më të shëndetshëm nga ana ekologjike dhe të ndërgjegjësojë njerëzit për pasojat që mund të sjellë zgjedhja e materialeve të ndryshme tekstile që ata përdorin, në krahasim me Eko-tekstilet.

Fjalët kyçe: eko-tekstile, fibra te ricikluara

ECO – TEXTILES. PRODUCTION AND THEIR APPLICATION FIELDS

M.Sc. Eng. Silva SPAHIJA¹

¹Polytechnic University of Tirana
Textile and Fashion Department
silva.spahija@upt-tekstilmoda.org

Abstract: The textile industry is considered as the most ecological and environmental friendly technology in the world, because it needs a wide utilization of water and chemical substances. Ecological problems in textile industry become during a lot of production processes and go ahead the final product. There are three factors to consider, while we evaluate the compatibility of textile products with the nature:

- Production
- Consumption
- Waste

Eco-textiles are textiles made from organic fibers, with friendly-ecological dyeing and finishing processes. They are textile products that can be produced, used without destroying the ecological balance and human health. The eco-textiles production technology, is trying to make their production healthy to ecological aspect and to make the people conscientious for the consequence of using other textiles instead of eco-textiles.

Keywords: *eco-textiles, recycled fibers*

SKANIMI 3D I TRUPIT

Ing. Tatjana SPAHIU¹, Ing. Ilda KOLA²

¹Universiteti Politeknik i Tiranës
Departamenti i Tekstilit dhe Modës

²Shkolla e Doktoratës “Inxhinieri Mekanike” Drejtimi Materiale Tekstile
tatjana.spahiu@upt-tekstilmoda.org

Abstrakt: Për analizën hapësinore të pamjes dhe përshtatshmërisë së veshjes, është thelbësor dixhitalizimi 3D i formës së trupit dhe sipërfaqes së veshjes. Qysh prej 1980, skanimi 3D i është kushtuar një vëmendje e madhe dhe është aplikuar gjerësisht në fushën e veshjeve. Variacioni në përmasat dhe format e trupit mund të vlerësohet në rrugë sasiore dhe shprehet nga skemat e konturit ose poligonet. Katër aplikimet kryesore të skanimi të trupit në veshje janë: matja pa kontakt e trupit për analizimin e përmasës, prodhimi i kallëpeve për veshjet në masë, një manekin i bërë me porosi për një treg të planifikuar, dhe vlerësimi i përshtatshmërisë së veshjes nga pamja e jashtme, të tilla si derdhshmëria, rrudhosjet dhe zgjerimi. Përveç veshjeve, ajo mund të aplikohet gjithashtu në fushën e mjekësisë për ekzaminimin e deformimeve të shtyllës kurrizore, volumin e gjoksit dhe barkut gjatë shtatzënisë, paralizën faciale dhe shpërndarjen e dhjemit. Midis kaq shumë mundësish aplikimi, rezultati më i përdorshëm i skanimi 3D të trupit është rrjetëzimi pikësor i të dhënave që përdoret për ndërtimin e modeleve fizik ose virtual të veshjeve, si dhe pikat kritike të referimit dhe të dhënat antropometrike të ndihmojnë në dizejnimin dhe përmasimin e veshjeve. Një avantazh i rëndësishëm i pjesës më të madhe të skanerave 3D të trupit është koha shumë e shpejtë e skanimi dhe shumëzimi më i saktë i përmasave. Kjo pajisje nxjerr një numër të pakufizuar përmasash lineare dhe jolineare të trupit të njeriut në vetëm pak sekonda. Gjithashtu e dërgon informacionin në një format dixhital i cili mund të integrohet automatikisht në sistemet CAD të veshjeve, të tilla si Gerber dhe Lectra. Kjo bën të mundur krijimin e veshjeve, të cilat mund të përshtaten në format tre-dimensionale të trupave të veçantë njerëzor. Në këtë artikull trajtohet zhvillimi, teknologjitë dhe aplikimi i matjes pa kontakt të trupit dhe sistemet e analizimit të veshjes në katër kategori: topografia moire, skanimi laser, skanimi infrared dhe fotogrametria.

Fjalë kyç: skanimi 3D, trupi, veshje, format dixhital, Lectra

3D BODY SCANNING

Eng. Tatjana SPAHIU¹, Eng. Ilda KOLA²

¹Polytechnic University of Tirana
Department of Textile and Fashion

²“Mechanical Engineering” PhD School, Textile Materials Field
tatjana.spahiu@upt-tekstilmoda.org

Abstract: For the spatial analysis of clothing appearance and fit, a 3D digitization of body form and clothing surface is essential. Since the late 1980s, 3D body scanning has received great attention and wide application in the clothing field. Variation in body size and shape can be assessed quantitatively and expressed by contour maps or polygons. The following are four main clothing applications of body scanning: non-contact body measurements for size survey, pattern generation for customization, a tailor-made mannequin for a target market, and clothing fit evaluation of appearance, such as drape, wrinkling and bagging. Other than clothing, it can be applied also in the medical field for the screening of spinal deformities, the bust and abdomen volume during pregnancy, facial palsy and fat distribution. Among so many possible applications, the main applicable result of 3D body scanning is the point data cloud to be used for the generation of virtual or physical dress model, critical landmarks and anthropometric data to guide the design and sizing of garments. One significant advantage of most 3D body scanners is the rapid scanning time and more accurate reproducible measurements. This machine generates an unlimited number of linear and nonlinear measurements of the human body in just a few seconds. It also delivers the output in a digital format which can be integrated automatically into apparel CAD systems such as Gerber and Lectra. This makes it possible to create garments which can mould to the three-dimensional shapes of unique human bodies. This paper reviews the development, technologies and applications of non-contact body measurement and garment analysis systems in four categories: moiré topography, laser scanning, infrared scanning and photogrammetry.

Keywords: 3D scanning, human body, clothing, digital format, Lectra

BAZAT E ANTROPOLOGJISË DHE ANTROPOLOGJIA E ARTIT

Jonida SHEHI (DIKA)

Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti i Tekstilit dhe Modës
jonidashehi@yahoo.com

Abstrakt: Në këtë material flitet për pjesën e antropologjisë, e cila studion njeriun në të gjitha këndvështrimet dhe veprimtaritë jetësore, qoftë ato shoqërore ashtu dhe ato kulturore dhe fizike. Gjithashtu, në këtë material flitet dhe për antropologjinë e artit apo njohuritë e njeriut mbi artin në tërësi dhe atë trupor, pra flitet se si është zhvilluar dhe se si ka evoluar arti skulptural, arti i qepjes, i thurjes, etj., ndër shekuj, në kontinente, shtete e deri në qelizën më të vogël, familjen dhe deri tek individi.

Fjalë kyçe: antropologji, arti trupor, arti i thurjes

FUNDAMENTAL OF ANTHROPOLOGY AND ANTHROPOLOGY OF ART

Jonida SHEHI (DIKA)

Polytechnic University of Tirana, Mechanical Engineering Faculty
Department of Textile and Fashion
jonidashehi@yahoo.com

Abstract: The following literature introduces the matter of the Anthropology, which observes the mankind in many points of view and life activity regarding cultural, physical and social fields etc. Furthermore this literature talks about the Anthropology of Art or as well the knowledge of human about Art and Sculptural art in general. Here is explained how it is developed and evolved the sculptural, sewing, knitting etc, during centuries, in different continents, countries and even different families and individuals.

Keywords: anthropology, body art, art of weaving

MEKANIZMAT TIP QË PERDOREN NË MAKINAT QEPËSE “SINGER”

Odise KOÇA¹, Miranda KULLOLLI¹, Lenonard.ÇOMENI²

¹Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti i Mekanikës

² Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
Departamenti i Strukturave
odisekoca2008@hotmail.com

Abstrakt: Në këtë punim flitet për sistemin lëvizës të makinave të vjetra “Singer”. Në ndërtimin strukturor të këtyre makinave bëjnë pjesë shumë mekanizma bazë dhe mungojnë të gjithë objektet ndihmës elektrike, pra bëhet fjalë për makinat klasike. Këtu analizohet skema kinematike e saj, çiftet kinematike kryesore që përdoren për realizimin e kësaj lëvizje të komplikuar, siç është ajo që realizon makina qepëse.

Fjalë kyçe: *skemë kinematike, çifte kinematike, makina qepëse, Singer*

BASIC MECHANISM USED IN THE “SINGER” SEWING MACHINES

Odise KOÇA¹, Miranda KULLOLLI¹, Lenonard.ÇOMENI²

¹ Polytechnic University of Tirana, Mechanical Engineering Faculty
Mechanical Department

² Polytechnic University of Tirana, Civil Engineering Faculty
Department of Structures
odisekoca2008@hotmail.com

Abstract: This paper deals with moving system of the old sewing machine “Singer”. In the structural construction of these machines there are many basic mechanisms and there is a lack of all electrical auxiliary facilities, so it may classify as classic machine. Here we analyzed its cinematic scheme, cinematic couples that are used to perform this complicated motion, such as that implemented by sewing machines.

Keywords: *cinematic scheme, cinematic couples, sewing machines, Singer*

POTENCIALET, ALTERNATIVAT DHE AVANTAZHET E INTEGRIMIT TË SISTEMEVE INTELIGJENTE NË TEKSTILE

Prof. Assoc. Orion ZAVALANI, Ing. G. DUME

Universiteti Politeknik i Tiranës
Fakulteti Inxhinierisë Elektrike
gentian.dume@gmail.com

Abstrakt: Materialet tekstile janë të pranishme kudo e në çdo kohë. Përparimi i shkencës së materialeve dhe elektronikës i ka “shtuar inteligjencë” tekstileve duke krijuar “rrobat e zgjuara”. Ky realitet po e transformon industrinë tradicionale të tekstit në një industri me nivel të lartë teknologjik. “Tekstilet e zgjuara” mund të reagojnë ndaj kushteve të mjedisit ose ngacmimeve të jashtme. Materiale të tilla gjejnë një përdorim të gjerë praktik në shume fusha si p.sh.: në ushtri, në kujdesin shëndetësor, në ruajtjen e higjienës, në argëtim, etj. Marrëdhënia e ngushtë e “tekstileve të zgjuara” me “kompjuterin prej cope” ofron shumë mundësi dhe hapësira hulumtimi. Një pjesë e materialeve dhe strukturave “të zgjuara” prej tekstili kanë arritur tashmë fazën e komercializimit dhe janë në treg. Një pjesë edhe më e madhe është në zhvillim ose ende në stadin fillestar të kërkimit. Në këtë artikull për “tekstilet e zgjuara” do të paraqesim një pasqyrë të shkurtër në lidhje me këtë teknologji në rritje si dhe potencialet, alternativat dhe avantazhet e integrimit të sistemeve inteligjente në tekstile. Këndvështrim ynë në këtë punim është thjesht teknik, duke lënë mënjanë aspektet të tjera interesante si p.sh., ato sociale, kulturore apo ekonomike, për punime të mëvonshme.

POTENTIALS, ALTERNATIVES AND ADVANTAGES OF INTEGRATING INTELLIGENT SYSTEMS IN SMART TEXTILES

Prof. Assoc. Orion ZAVALANI, Eng. G.DUME

Polytechnic University of Tirana
Faculty of Electrical Engineering
gentian.dume@gmail.com

Abstract: Textiles are present everywhere and any time. Advances in material science and electronics have added intelligence to textiles and created “smart clothes”. The advent of smart textiles makes it possible to bring the traditional textile sector to a level of high-technological industry. Smart textiles can sense and react to environmental conditions or stimuli. Such textiles find uses in many applications ranging from military and security to personalized healthcare, hygiene and entertainment. Their close relationship with the field of computer wearable offers many diverging research directions. A part of these new materials and structures have already reached the stage of commercialization, a much larger part however is still in full development or still has to be invented even. This article about smart textiles presents a short overview about this growing technology. Potentials, alternatives and advantages of integrating intelligent systems in smart textiles are presented. The viewpoint is technical, leaving e.g. social changes, cultural references and economic aspects to other papers.

